



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 502/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.07.2019, shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 1197 prot., datë 03.07.2019 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Rehabilitim i skemës ujitëse të Ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza 3)”, me nr. REF-19042-04-19-2019, me fond limit 42,532,808 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” sh.p.k.  
Adresa: Rr. “Adem Jashari”, Nd.4, H.10, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Mirditë  
Adresa: Sheshi “Abat Doci”, Rrëshën, Mirditë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### ***Vlerësimi paraprak***

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

### **II**

#### ***Rrethanat e çështjes***

II.1. Në datën 24.04.2019 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Rehabilitim i skemës ujitëse të Ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza 3)*”, me nr. REF-19042-04-19-2019, me fond limit 42,532,808 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

II.2. Në datën 21.06.2019, operatori ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 26.06.2019 autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën e paraqitur pranë këtij të fundit, duke mos e pranuar atë.

II.4. Në datën 03.07.2019 operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 30.07.2019, operatori ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” sh.p.k. ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë, me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Rehabilitim i skemës ujitëse të Ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza 3)*”, me nr. REF-19042-04-19-2019, me fond limit 42,532,808 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Konstruksion” sh.p.k. për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Rehabilitim i skemës ujitëse të Ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza 3)*”, me nr. REF-19042-04-19-2019, me fond limit 42,532,808 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” i cili në nenin 94, “*Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës*”, pika 1 parashikon se “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.*”

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimit të tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Rehabilitim i skemës ujitëse të Ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza 3)*”, me nr. *REF-19042-04-19-2019*, me fond limit *42,532,808* lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën *27.05.2019*, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1197 Protokolli Datë 03.07.2019**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**